

Data: 27.06.2024

## PROCESVERBAL-SHERBIME

### “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURES: “Shërbim Kolaudimi për Infrastrukturën urbane për zonat e shpallura për rindërtim.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,048,357.92 leke pa tvsh.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 35721000-4

Në bazë të Aktit Normativ Nr. 9, Datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me ligjin NR. 97/2019, VKM 199/2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit për punët, shërbimet dhe mallrat, kriteret e vlerësimit të ofertës fituese, kushtet e marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për rindërtimin” nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik Fondi Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

*1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:*

*a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;*

*c. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5;*

*ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

*d. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;*

*dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 10;*

*e. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas shtojcës 11.*

*ë. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*

*2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:*

*(të plotësohet nga autoriteti përgjegjës),*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen ne VKM 199/2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit për punët, shërbimet dhe mallrat, kriteret e vlerësimit të ofertës fituese, kushtet e marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për rindërtimin”.

#### 2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 9 të DST.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së parashikuar të marrevshjes në procedurën e prokurimit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.*

Argumentimi për kriterin 2.2: Këto kriteret janë vendosur në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, bazuar në nenin 42 të Aktit Normativ 9/2019, nenin 77, pika 3, e LPP dhe nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" Autoriteti në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

---

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme:

a) OE duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Vlera e kërkuar për shërbimet e mëparshme nuk duhet të jetë me e vogël se 20 % të vlerës së fondit të marrëveshjes kuadër pa TVSH të realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates.

- Per kete OE duhet te paraqese vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kriteri është miratuar me qëllim vërtetimin për eksperiencat e ngjashme të operatorit/ëve në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin e objektit të kontrates, kolaudimin e punimeve për infrastrukturën publike në zonat e shpallura për rindertim. Përvoja e operatorit është element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Referuar në nenin 41 VKM 285/2021 kërkon që për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon, dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në

një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimi të kontratës. Në kuptim të nenit 28, vlerësohet e vlera e kërkuar në masen jo më të vogël se 20 % është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës rrjedhimisht nuk sjellë kufizim të pjesëmarrjes në garë të o peratorëve. Vlera e përcaktuar nga grupi është më e vogël se vlera që parashikon dispozita ligjore për kontratat e shërbimeve.

2.3.2 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës të lëshuar nga Ministria kompetente e kohës, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 759, datë 12.11.2014 Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- N.P – 1 Punime gërmimi në tokë.
- N.P – 4 Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- N.P – 7 Ujesjellesa, gazsjellesa. vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
- N.P – 11 Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- N.P – 12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- N.S – 1. Punime për prishjen e ndertimeve
- N.S – 6 Sinjalistika rrugore jo ndriçuese
- N.S – 8 Ndertime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri
- N.S – 18 Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondojnë me të njëjtin numër kategorie me kategorinë në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

**Argumentimi:** Përcaktimi i kategorisë dhe klasifikimit të licensave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore dhe teknike. Referuar në nenin 41 pika 4/a të VKM nr. 285/2021 parashikohet shprehimisht: “5 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore...” Kategoritë e licensave janë vendosur duke mbajtur parasysh bazën ligjore për ndërtimet, Ligji nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar dhe VKM-së nr.759/2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës për

kolaudimin, për infrastrukturën publike, ndricimi rrugor, sheshe, rruge locale, rruge urbane dytesore, interurbane dytesore, ujësjellës kanalizimime urbane rurale, infrastrukturen e furnizimit me uje dhe largimit te ujrave te perdorura apo ato te shiut, infrastrukturen e furnizimit me energji elektrike, infrastrukturen e telefonise dhe rrjetit te informacionit, infrastrukturen komunitare te shesheve, parqeve, terreneve sportive, ndricimit publik në zonat e prekura nga tërmeti në kuadër të rindërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Procedura e prokurimit të rindërtimit është procedurë e përshpejtuar dhe afatet janë të shkurtuara. Nisur nga fakti që akti normativ parashikon procedurën e përshpejtuar të njëhësimi të licencave të huaja, autoriteti ka parashikuar lehtësim në dorëzimin e licencave të operatorëve të huaj pa renë ndesh me kërkesat thelbësore të kategorive të licencave që lëshohen nga autoritetet shqiptare..

2.3.3 Staf i kryesor i inxhinierëve të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit është:

- Inxhinier Ndertimi	minimumi	1(një)
- Arkitekt/Urbanist	minimumi	1(një)
- Inxhinier Konstruktor	minimumi	1(një)
- Inxhinier Gjeodet	minimumi	1(një)
- Inxhinier Elektrik	minimumi	1(nje)
- Inxhinier Hidroteknik	minimumi	1(nje)

Stafi mbështetës:

Inxhinier Mekanik	minimumi	1(një)
Inxhinier Gjeolog	minimumi	1(një)
Inxhinier Mjedisi	minimumi	1(nje)

- Stafi i nxhinierëve duhet të jenë pjesë e stafit të operatorit ekonomik dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve për periudhën tre mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Si dëshmi duhet të dorëzohen listepagesat.
- Për secilin prej inxhinierëve të lartpërmendur (staf kryesor dhe mbështetës) Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin kualifikimet arsimore (diplomat) dhe CV

**Argumentimi:** Referuar në nenin nenin 41 pika 4/b të VKM nr. 285/2021 parashikohet shprehimisht: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla...” Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me numrin e objekteve të kontrates dhe vendndodhjen e tyre. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit për infrastrukturën publike, ndricimi rrugor, sheshe, rruge locale, rruge urbane dytesore, interurbane

dytesore, ujësjellës kanalizimime urbane rurale, infrastrukturen e furnizimit me uje dhe largimit te ujrave te perdorura apo ato te shiut, infrastrukturen e furnizimit me energji elektrike, infrastrukturen e telefonise dhe rrjetit te informacionit, infrastrukturen komunitare te shesheve, parqeve, terreneve sportive, ndricimit publik në zonat e prekura nga tërmeti në kuadër të rindërtimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve, gjeodet, arkitekt/urbanist, elektrik, hidroteknik, mekanik, gjeolog është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe kolaudimin e punimeve, duke ju referuar vendndodhjes në zonat e dëmtuara nga tërmeti. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Personeli teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm gjatë kolaudimit. Në lidhje me inxhinierin e mjedisit operatori/ët ekonomik/ë gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatësë lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ku në nenin 1 parashikohet shprehimisht: *“Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit”* dhe VKM-se nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo operator ekonomik, person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Deklarimi dhe regjistrimi i staafit teknik në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës (sidomos të grupeve të rrezikuara sikurse përcaktimet në shtojcën 10 të DST).

2.3.4 Numri i punonjësve: Operatori Ekonomik duhet te kete jo me pak se 10 (dhjete) punonjës te siguruar për çdo muaj për periudhen tre mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Per te vertetuar kete kusht, operatori Ekonomik duhet te paraqese vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhen tre mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit, i cili duhet te perputhet me liste pagesat e punonjsve për kete periudhe.

Argumentimi: - Referuar në nenin 41 pika 4/c te VKM nr. 285/2021 parashikohet shprehimisht: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: “c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.” Në përcaktimin e numrit te punonjësve grupi i specialistëve ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si kualifikimi i punonjësve, afatin kohor dhe orët e punës per kolaudimin e punimve për infrastrukturën publike, ndricimi rrugor, sheshe, rruge locale, rruge urbane dytesore, interurbane dytesore, ujësjellës kanalizimime urbane rurale, infrastrukturen e furnizimit me uje dhe largimit te ujrave te perdorura apo ato te shiut, infrastrukturen e furnizimit me energji elektrike, infrastrukturen e telefonise dhe rrjetit te

informacionit, infrastrukturen komunitare te shesheve, parqeve, terreneve sportive, ndricimit publik në zonat e prekura nga tërmeti në kuadër të rindërtimit. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrate tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

## **II.Kriteret e përzgjedhjes së fituesit per Fazën e II te minikonkursit:**

Jane parashikur ne Aktin Normativ Nr. 9, Datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me ligjin nr. 97/2019, VKM 199/2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit për punët, shërbimet dhe mallrat, kriteret e vlerësimit të ofertës fituese, kushtet e marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për rindërtimin.

Oferta ekonomikisht më e favorshme X

lidhur me rëndësinë:

**(i) Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit. [0 - 10]**

Operatori ekonomik duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e specifikimeve teknike, preventivin dhe kostot në plan pune konkrete, me qëllim për të realizuar punimet sipas afatit.

***Shënim;** Autoriteti përgjegjës rezervon të drejtën që nëse koha e zbatimit do të jetë më e ulët se 80% e afatit të përcaktuar nga autoriteti përgjegjës, do të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin për kualifikimin ose jo të tyre. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të kohës së zbatimit.*

**(ii) Çmimi më i ulët [0 - 60]**

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën.

**(iii) Cilësia [0 - 30]**

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shmebull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të zbatimit dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi

Autoriteti rezervon te drejten në fazën e dytë të minikonkursit në ftesën për ofertë të jap shpjegime më të detajuara të lidhur me kriteret e përzgjedhjes.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Termet e referencës janë hartuar sipas standardeve dhe në përputhje me perkatimet ligjore në fuqi dhe janë pjesë e pandare e DST.*